



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 749/4 Prot

Tiranë, më 29.07.2016

VENDIM

Nr. 42, datë 29.07.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr.168, datë 06.07.2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 11.07.2016, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit, Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër, me objekt:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri nga kontrolluesi Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër, gjatë kryerjes së veprimtarisë të tij në fushën e arsimit.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrit Nr.168, datë 06.07.2016 të Komisionerit "Për kryerjen e hetimit administrativ" që do të ushtrohej pranë këtij kontrolluesi.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi nuk e ka kryer "Njoftimin" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 21-22 të ligjit;
2. Kontrolluesi nuk ka rregullore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale;
3. Konstatohet se vetë mësuesit e caktuar si mbikëqyrës të maturës shtetërore kanë firmosur deklaratën e konfidencialitetit, modelin tip të kërkuar nga AKP.
4. Nga rregullorja funksionale e D.A.R. Shkodër, konstatohet se nuk ka rregulla mbi konfidencialitetin e mësuesve dhe psikologëve. Dosjet e personelit administrativ dhe mësimdhënës, nuk u vunë në dispozicion të grupit të inspektimit, me pretendimin se punonjësit e burimeve njerëzore kanë marrë lejen e zakonshme.
5. Konstatohet se D.A.R. Shkodër administron vetëm një adresë zyrtare të postës elektronike (e-Mail) dhe të gjithë punëmarrësit gjatë orarit zyrtar komunikojnë

nëpërmjet postës elektronike personale me njëri-tjetrin. Adresa e postës elektronike mundësohet nga M.A.S.

6. Konstatohet se ambientet e gjimnazit "28 Nëntori", janë të mbikëqyrura nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), por nuk janë vendosur tabela informuese mbi prezencën e këtij sistemi;
7. Konstatohet se dosjet personale të krijuara nga psikologët ruhen për një periudhë të pacaktuar pasi koha e ruajtjes së të dhënave nuk është e përcaktuar në rregullore apo udhëzime specifike.

Faktet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 18, 21, 22, 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverballi i bashkëngjiten këto dokumente:

- Rregullore e brendshme e funksionimit të D.A.R. Shkodër;
- Deklaratë konfidencialiteti të mësuesve mbikëqyrës të maturës shtetërore;
- Tabela me të dhëna statistikore drejtuar institucioneve të ndryshme;
- Fotografi nga ambientet e gjimnazit "28 Nëntori".

Në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, por veçanërisht dhe në mbështetje të Udhëzimit të MAS-it Nr.12, datë 27.04.2015 "Për mbledhjen përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale", duhej të ishin marrë masat e duhura, ato më kryesoret që krijojnë një lloj sigurie dhe ecurie fillestare në mbrojtjen e të dhënave:

1-Formulari i Njoftimit, i cili nuk përmendet në këtë udhëzim, për faktin se ky formular konsiderohet të jetë kryer kohë para se të dilte akti nënligjor në fjalë.

2- Rregullorja e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale, (pika 19) sipas këtij udhëzimi.

3- Deklarata e Konfidencialitetit, (pika 14, gërma "b"), sipas këtij udhëzimi.

Siç dhe konstatohet në proces verbal, detyrimin për njoftim kontrolluesi nuk e kishte përmbushur, por në datë 11.07.2016, me Nr.2523/1 prot, DAR Shkodër ka depozituar Formularin e Njoftimit, pranë Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi D.A.R. Shkodër efektin e Deklaratës së Konfidencialitetit e kishte të kufizuar vetëm për mësuesit e caktuar nga AKP-ja, si mbikëqyrës të maturës shtetërore. Personeli i Zyrave Arsimore Vendore, si dhe shkollat e tyre, nuk aplikojnë Deklaratat e Konfidencialitetit për punëmarrësit që aksesojnë të dhënat personale.

Në lidhje me shërbimin psikosocial që ofrohet në shkollat 9-vjeçare dhe ato të mesme, psikologët dhe punonjësit e shërbimit social, të cilët mbledhin dhe përpunojnë të dhëna sensitive të nxënësve vulnerabël, të nxënësve me probleme sociale, apo nxënësve problematikë në komunitet, nuk aplikojnë Deklaratë Konfidencialiteti.

Në pikën 18 të po këtij udhëzimi, parashikohet: “*Transmetimi dhe arkivimi i dosjeve të të dhënave*”, mënyra e transmetimit të dosjeve, “*Kur një subjekt i një institucioni arsimor transferohet në një institucion tjetër, drejtori i institucionit i dorëzon me procesverbal drejtorit të institucionit pritës dosjen personale përkatëse*”. Mungesa e këtij transmetimi u konstatua me dosjet e nxënësve me aftësi të kufizuara, të cilat ruheshin nga psikologët sipas vlerësimit të tyre, pasi që nuk kishin një bazë ligjore për afatin e ruajtjes, por edhe nuk kishin dijeni për këtë udhëzim.

Shumica e institucioneve të DAR-ve në vend, në strukturën e tyre kanë dhe shkollat speciale, të cilat trajtojnë fëmijët me aftësi të kufizuara. Gjatë gjithë procesit të hetimit administrativ në fushën e arsimit, grupi i kontrollit nuk konstatoi një rregullore të veçantë apo dhe klauzola brenda rregulloreve funksionale për mënyrën se si administrohen, për kohën dhe mënyrën se si ruhen, apo transmetohen të dhënat sensitive të kësaj kategorie.

DAR Shkodër, po ashtu dhe të gjitha DAR-et në vend, kanë vetëm një adresë zyrtare, për komunikimin elektronik gjatë ushtrimit të detyrës, dhe komunikimi zyrtar kryhet nëpërmjet adresave personale elektronike të punonjësve. Kjo është një shkelje flagrante dhe jo vetëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, por dhe për vetë sistemin arsimor në tërësi, pasi komunikimi administrativ zyrtar i kryer nëpërmjet postës elektronike personale të punonjësve, i heq të drejtat kontrolluesit mbi këtë komunikim.

Në vazhdim të procedurës, u hartua procesverbali i cili u lexua në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit. Përfaqësuesit e kontrolluesit nuk paraqitën pretendime, por u shprehën se do të përmbushin konstatimet e dala nga ky kontroll dhe do i paraqesin ato para seancës dëgjimore.

Në zbatim të neneve 87 - 89 të Ligjit Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, datë 30.04.2015, në datë 19.07.2016, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ.

Në seancë dëgjimore përfaqësuesi i kontrolluesit, u paraqit për të shprehur pretendimet e tij, duke i depozituar ato dhe të shkruara, duke bërë me dije:

1-Në datë 11.07.2016 është plotësuar nga D.A.R. Shkodër Formulari i Njoftimit, dhe faktehet në rregjistrin e Komisionerit.

2-Me Urdhrin nr.2540 prot., datë 12.07.2016 të titullarit D.A.R. Shkodër është ngritur grupi i punës për hartimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale. (e depozituar në seancë dëgjimore)

3-Gjithashtu D.A.R., Shkodër, rregulloren e përfunduar për mbrojtjen e të dhënave personale, do ta dërgojë në shkollat, të cilat aktualisht janë të mbyllura.

4-Ndër pretendimet tona si institucion, paraqesim dhe faktin që në procesverbalin e datës 11.07.2016, nga ana e përfaqësuesve të Komisionerit nuk janë gjetur raste të përpunimit të të dhënave personale, në shkelje nga ana jonë, përveç faktit që nuk është kryer formulari i njoftimit, të cilin e kemi përmbushur që atë ditë.

5-Tjetër fakt është që në Rregulloren e DAR Shkodër, është përcaktuar në parim mbrojtja e të dhënave personale, paçka se duhet të ishte më e zgjeruar dhe më e azhurnuar me udhëzimet e aktet e tjera ligjore e nënligjore të dala në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit, në lidhje me pretendimet e mësipërme shprehet:

1-Mos plotësimi i Formularit të Njoftimit, është një shkelje flagrante, pasi është procesi fillestar i mbrojtjes së të dhënave personale. Në sajë të përmbushjes të këtij detyrimi në kohë reale, Komisioneri nuk ka penalizuar kontrolluesin DAR Shkodër sipas nenit 39, paragrafi 1, gërma "d", i cili shprehet: *"..kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë"*.

2- Mungesa e një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, do të thotë mungesë masash paraprake, me qëllim mos ndodhë kundravajtja. Mungesa e rregullores është një shkelje parashikuar në ligj, konkretisht në nenin 27 të tij, i penalizueshëm sipas nenit 39, paragrafi 1, gërma "dh" i tij, i cili shprehet: *"..kontrolluesit që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të përcaktuara në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë"*.

3-Mungesa e tabelave informuese, në ambientet ku instalohen dhe veprojnë kamerat e vëzhgimit (CCTV), është shkelje e nenit 18 të ligjit.

Komisioneri, duke parë reagimin e kontrolluesit D.A.R. Shkodër, në marrjen e masave konkrete mbi gjetjet e konstatuara nga grupi i kontrollit, njëherazi duke zbatuar parimin e proporcionalitetit, ka vlerësuar penalizimin simbolik, pasi Zyra e Komisionerit nuk ka qëllim në vetvete penalizimin, por ndërgjegjësimin jo vetëm të komunitetit, por dhe të institucioneve që përpunojnë të dhëna personale në përmasa potenciale.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika 1, gërma "dh" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, janë serioze për vetë faktin e përmasës së kontrolluesit, gamës së të dhënave sensitive që ky kontrollues mbledh e përpunon. Si të tilla këto shkelje përbëjnë *"kundërvajtje administrative"*, dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

"-dh) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë."

Kontrolluesi D.A.R. Shkodër, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, kryesisht për kategoritë *"nxënës"* dhe *"mësues"*.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 27, 28, 39 paragrafi 1, gërma "dh", si dhe nenit 39, paragrafi 2 i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit *Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër*, me gjobë në vlerën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit *Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër*, me gjobë në vlerën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi, *Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër*, të realizojë për Zyrat Arsimore të cilat janë në varësi të tij, pajisjen e kontratave të punëmarrësve me Deklaratat e Konfidencialitetit sipas Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013, si dhe të shtrijë efektet e rregullores së formalizuar për mbrojtjen e të dhënave personale pranë tyre, brenda një periudhe 3 mujore.
4. Kontrolluesi, *Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër*, në përputhje me Udhëzimin Nr.4, datë 16.03.2010 të Komisionerit "*Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimitt*", paragrafi 4, si dhe në përputhje me kushtet në të cilat ushtron detyrat, të përcaktojnë afatet e mbajtjes të të dhënave personale sensitive, për nxënësit me probleme sociale, nxënësit me probleme të shëndetit mendor, dhe nxënësit problematikë në sjellje.
5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 29.07.2016

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI